



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLES SE PARE VLORE

Nr. 1487 Rregjistri

Nr. 1096 Vendimi
Data 27/09/2001

V E N D I M
“ Në Emër të Republikës”

Ne Gjykatën e Shkallës së Parë Vlorë sot në dt.27/09/2001 trupi gjykues i përbërë nga:

Gjyqtar: Shkelzen Selimi

I asistuar nga sekretarja e seances Olta Bedaj mori në shqyrtim në seance gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile Nr.1487 që i përket:

Kerkues: Elca Bezhani, e bija e Qamilit, e dtl.1969, lindur dhe banuese në Vlorë, lagjia “Hajro Çakerri”, Nr.16/2.

Objekti: Leshim deshmi trashëgimie.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen në teresi, administroi provat, degjoi kerkuesen e cila kerkoi pranimin e kerkeses.

VEREN

Kerkuesja Elca Bezhani i është drejtuar gjykatës me një kerkese në të cilën kërkon çeljen e trashëgimisë ligjore për trashëgimlensin Artor Bezhani.

Nga shqyrtimi gjyqësor rezultoi se kerkuesja ishte bashkeshortja e të ndjerit Artor Bezhani i cili ka vdekur në dt.28/04/2000. Ky fakt provohet nga akti i vdekjes Nr.54 dt.24/09/2001, leshuar nga zyra e gjendjes civile Nr.1 Bashkia Vlorë. Trashëgimlensi ka qenë i martuar vetëm një herë me kerkuesen Elca Bezhani. Nga kjo martesë Artor Bezhani ka patur një fëmijë të quajtur Teodor Bezhani i dtl.19/12/1997. Ky fakt provohet nga çertifikata familjare Nr.16/2 dt.26/09/2001 leshuar nga zyra e gjendjes civile Nr.1 Bashkia Vlorë. Nga hetimi gjyqësor nuk rezultoi që trashëgimlensi të ketë disponuar me testament në lidhje me pasurinë. Në këto kushte për trashëgimlensin Artor Bezhani duhet të çëlet trashëgimia ligjore në bazë të nenit 317 të Kodit Civil. Në këtë nën thuhet:

“Trashëgimia me ligj zbatohet kur trashëgimlensi nuk ka bërë testament ose ka bërë vetëm për një pjesë të pasurisë së tij ...”

Në kushtet kur nga gjykata nuk konstatohet se trashëgimlensi nuk ka lënë testament atëherë me vendim gjyqësor çëlet trashëgimia ligjore duke thirrur në trashëgim trashëgimtarët ligjor sipas rradhës të përcaktuar në nenin 361 e vijues të Kodit Civil. Gjithashtu nga hetimi gjyqësor nuk rezultoi që trashëgimlensi të ketë shpallur të padenjë ndonjë prej trashëgimtarëve të tij.